

Hekurudhat Shqiptare

Vendndodhja: Shqipëri

ID e projektit: 48466

Sektori i Biznesit: Transport Hekurudhor

Tipi i Njoftimit: SHTETËROR

Kategoria Mjedisore: B

Data e Aprovimit: 30 Nëntor 2016

Statusi: Në proces shlyerjeje

Data e Publikimit në Anglisht: 21 Qershor 2016

Përshkrimi i Projektit

Aprovimi i një huaje sovrane deri në EUR 36.87 milionë për Republikën e Shqipërisë, në përfitim të Hekurudhave Shqiptare ("HSH" "Klienti" ose "Kompania"), për të financuar:

(i) rikonstruktionin dhe përmirësimin e rreth 34.7 km linjë hekurudhore midis Terminalit të Transportit Publik të Tiranës (TTP) dhe qytetit të Durrësit; dhe

(ii) ndërtimin e një linje hekurudhore prej afërsisht 7.4 km që lidh me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës ("TIA") (së bashku "Projekti").

Një rritje prej EUR 40.7 milionë e huasë sovrane ekzistuese prej EUR 36.87 milionë në përfitim të Republikës së Shqipërisë u sigurua për të financuar:

- (i) ndërtimin e rreth 8 stacioneve dhe ndalesave përgjatë linjës hekurudhore Tiranë-Durrës dhe përgjatë lidhjes së re hekurudhore me TIA;
- (ii) rritjen e kostove si rezultat i rregullimeve të çmimeve dhe përmirësimeve në projektim; dhe
- (iii) shërbime shtesë të mbikqyrjes së punimeve.

Një rritje shtesë e huasë deri në EUR 11.62 milionë do të ofrohet për të bashkëfinancuar elektrifikimin e linjave hekurudhore të financuara nga Projekti, përkatësisht, linjës hekurudhore TTP Tiranë-Durrës dhe linjës së re hekurudhore me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA).

Projekti bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian, përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor ("WBIF") e cila ka ofruar grante investimi deri në shumën EUR 32.94 milionë dhe grante për asistencë teknike deri në EUR 2.5 milionë. Grante shtesë nga WBIF pritet të ofrohen për të bashkëfinancuar komponentin e elektrifikimit të Projektit.

Objektivat e Projektit

Projekti është pjesë e Korridorit 2 të Rrjetit Kryesor të Ballkanit Perëndimor, i cili lidh qytetet e Podgoricës në Mal të Zi dhe Vlorës në Shqipëri dhe është përcaktuar si një zgjerim orientues i Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T) drejt rrjetit hekurudhor thelbësor të Ballkanit Perëndimor.

Projekti do të mbështesë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe do të kontribuojë në integrimin rajonal të saj, duke përmirësuar lidhjen ndërmjet qyteteve të Tiranës dhe Durrësit si dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA).

Ndikimi në Tranzicion

ETI 60

Ndikimi në tranzicion i Projektit do të bazohet në këto cilësi tranzicioni:

1. Mjedis i Gjelbër (Green) duke mbështetur zhvillimin e transportit me emetime të ulëta karboni, në përputhje me qasjen e BERZH-it për tranzicionin drejt një ekonomie të gjelbër. Rritja e parë e huasë do të përmirësojë cilësinë mjedisore "Green", pasi ndërtesat e stacioneve do të jenë me efikasitet të lartë energjie dhe do të arrijnë një performancë mbi 10% më të mirë se kriteret vendase për ndërtesa me pothuajse zero emetime ("nZEB"). Gjithashtu rritja e dytë e huasë për elektrifikimin e linjave hekurudhore do të kontribuojë më tej në uljen e emetimeve të CO₂.

2. Qeverisja e mirë nëpërmjet zhvillimit të një plani për menaxhimin e aseteve dhe një metodologjie për tarifat e hekurudhës, përmirësimit të sistemeve të kontabilitetit dhe raportimit të Kompanisë dhe nxitjes së përfshirjes ekonomike. Cilësia e Qeverisjes së mirë do të përforcohet gjithashtu përmes përfshirjes si objektiv shtesë të finalizimit të procesit aktual të ndarjes së funksioneve në Hekurudhën Shqiptare, ku pritet që operacionet e trenave të ndahen nga menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me legjislacionin e BE-së (*acquis communautaire*).

Informacioni për Klientin

SHTETI SHQIPTAR

Huamarrësi është Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Klienti dhe përfituesi i Projektit është Hekurudha Shqiptare, e cila është përgjegjëse për infrastrukturën hekurudhore dhe operacionet e trenave.

BERZH Përmbledhja Financiare

EUR 89,190,000.00

Një hua sovranë për Republikën e Shqipërisë

Kosto Totale e Projektit

EUR 165,267,000.00

Vlera e Shtuar

Vlera e shtuar vjen nga:

- (i) ofrimi i financimit afatgjatë, i cili aktualisht nuk është i disponueshëm në Shqipëri nga huadhënësit tregtar. Financimi i Bankës është gjithashtu komplementar përmes një sërë kushtëzimesh, të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit dhe efikasitetin e operacioneve të Kompanisë.
- (ii) komplementi jo-financiar, pasi plani i ndërtesave të stacioneve përfshin specifika që adresojnë pabarazitë gjinore në lidhje me lehtësimin e përdorimit të strukturës, sigurinë, mbrojtjen, komoditetin dhe përballueshmërinë. Për më tepër, Kompania do të përgatisë një plan veprimi për mundësi të barabarta ("EOAP"), me qëllim nxitjen e një vendi pune gjithëpërfshirës.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria B (2019 ESP) Gjetjet nga vlerësimi mjedisor dhe social për Projektin ("ESDD") u plotësuan nga një ESDD i veçantë për komponentin e elektrifikimit, i cili u realizua nga një konsulent i pavarur në vitin 2025 dhe përfshinte një shqyrtim të sistemeve të menaxhimit mjedisor dhe social ("E&S") si dhe Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor kombëtar. Të gjitha lejet përkatëse mjedisore janë siguruar në përputhje me legjislacionin shqiptar. Mangësitë e identifikuar gjatë ESDD-së për elektrifikimin janë përfshirë në Planin e rishikuar të Veprimit Mjedisor dhe Social ("ESAP"), i cili do të dakordësohet përpara dorëzimit të dokumentacionit përkatës të projektit në Bordin e Drejtorëve të BERZH-it.

Një sistem i integruar i menaxhimit mjedisor dhe social ("ESMS") është zhvilluar me mbështetjen e Bankës dhe është në fazë zbatimi, me disa vonesa për shkak të ndryshimeve organizative dhe mungesës së kapaciteteve në Hekurudhën Shqiptare. Përputhshmëria e Shoqërisë me Kërkesat e Performancës së BERZH-it ("PRs") po monitorohet përmes shqyrtimit të raporteve vjetore mjedisore dhe sociale, duke përfshirë edhe zbatimin e ESAP dhe vizitat në terren. Si pjesë e projektit ekzistues, Kompania po bën ndryshime në plan për të përmirësuar qasjen për komunitetet që jetojnë pranë linjës hekurudhore. Gjithashtu Hekurudha Shqiptare në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, vazhdojnë zbatimin e Planit për Marrjen e Tokës dhe Rivendosjen e Jetesës ("LALRP"). ESAP-i është në proces zbatimi dhe njësia e zbatimit të projektit ("PIU") mbështetet nga një konsulent, për ta zbatuar Projektin në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse. Kapacitetet e Klientit do të forcohen më tej përmes mbështetjes shtesë të bashkëpunimit teknik ("TC").

Praktikat e punës së Shoqërisë janë në përgjithësi të përshtatshme. Banka ka ofruar një TC për të forcuar më tej sistemet e burimeve njerëzore (HR) të Kompanisë dhe për të promovuar barazinë gjinore. Hekurudha Shqiptare është aktualisht në një proces rristurimi, i cili përfundimisht do të çojë në ndarjen e kompanisë në dy njësi të veçanta, përgjegjëse përkatësisht për infrastrukturën dhe operacionet e trenave. Çdo shkurtim i mundshëm i stafit si rezultat i këtij riorganizimi do të duhet të ndjekë

një plan shkurtimi në përputhje me Kërkesën e Performancës PR2 dhe legjislacionin kombëtar dhe është i përfshirë në ESAP-in e përditësuar.

Ndikimet mjedisore të komponentit të elektrifikimit dhe masat e zbutjes për të adresuar zhurmën, ndotjen e tokës dhe menaxhimin e mbetjeve janë të përfshira në mënyrë të përshtatshme në Vlerësimin Kombëtar të Ndikimit në Mjedis("EIA") dhe janë integruar në ESAP. Punimet nuk prekin zona të mbrojtura dhe nuk lidhen me ndikime në biodiversitet. Çështjet e sigurisë së komunitetit për shkak të kalimeve hekurudhore të paautorizuara janë adresuar përmes zgjidhjeve të aksesit të integruara në projektin inxhinierik, përfshirë rrethime të përshtatshme. Komponenti i elektrifikimit mund të kërkojë tokë shtesë në sasi të kufizuar për nënstacione dhe lidhje kabllorë. Ndikimet nga marrja e tokës dhe aksesit, përfshirë ato mbi tokat bujqësore dhe përdoruesit informalë, janë vlerësuar për të siguruar përputhshmëri me PR5. Hekurudha Shqiptare ka zbatuar një plan për marrjen e tokës dhe rivendosjen e jetesës për punimet kryesore të rehabilitimit dhe një plan shtesë për komponentin e elektrifikimit do të zbatohet përpara fillimit të ndërtimit.

Plani për angazhimin e palëve të interesit ("SEP") është përditësuar për të pasqyruar përfshirjen e komponentit të elektrifikimit, duke përfshirë konsultimet e vazhdueshme mbi përdorimin, marrjen e tokës, ndikimet nga ndërtimi dhe çështjet e sigurisë, veçanërisht për grupet vulnerabël. SEP-i dhe përmbledhja e përditësuar jo-teknike ("NTS") do të behen publike nga Hekurudha Shqiptare dhe janë shtuar në Dokumentin Përmbledhës të Projektit("PSD"). Një mekanizëm ankesash në nivel projekti vazhdon të jetë në fuqi për të adresuar çdo shqetësim nga palët e interesit.

Mbështetja Teknike për përputhshmëri mjedisore, shëndetësore, të sigurisë dhe sociale("EHSS") gjatë fazës së ndërtimit do të vazhdojë edhe gjatë fazës së elektrifikimit. Banka do të vijojë mbikëqyrjen përmes raportimeve të rregullta dhe vizitave monitoruese.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Granteve

Detyrat e Bashkëpunimit Teknik të parashikuara si pjesë e këtij projekti përfshijnë:

1. Mbështetje për zbatimin e projektit;
2. Forcim institucional për të ndihmuar në përgatitjen e një plani për menaxhimin e aseteve dhe të tarifave të qasjes në hekurudhë në Shqipëri;
3. Ndërtim kapacitetesh për përmirësimin e sistemeve të kontabilitetit të Hekurudhës Shqiptare ("HSH") për të siguruar përputhshmëri me standardet IFRS;
4. Zhvillimi i Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social gjatë ndërtimit, si dhe shërbimeve për menaxhimin EHSS (mjedis,shëndet,siguri dhe çështje sociale);
5. Shërbime të mbikëqyrjes së punimeve;
- 6.Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social gjatë ndërtimit si dhe shërbimeve për ndërtimin e ndërtesave të stacioneve përgjatë linjave hekurudhore të financuara nga Projekti;

7. Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për të promovuar përdorimin e sigurt dhe përfitimet e qëndrueshme të transportit hekurudhor në Shqipëri;
8. Zbatimi i politikave dhe praktikave të përmirësuara të burimeve njerëzore nga Kompania, me fokus në mundësitë e barabarta.
9. Përgatitja e analizës kosto-përfitim ("CBA"), të projektit paraprak dhe ESIA-së për elektrifikimin e linjave hekurudhore të financuara nga Projekti.

Informacion Kontakti i Kompanisë

Z.Ergys Verdho, Administrator

ergys.verdho@hekurudha.al

+355 522 22037

Hekurudha Shqiptare Lagjia nr. 3, Rruga "Egnatia" Durres, Shqipëri

Përditësimi i fundit i PSD-së

4 Gusht 2025

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH:](#)

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.